



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644 – 24 – 7417 – 1-3-6/C954  
14 Nr. 780/24  
Dt. 26.09.2024

## KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: – Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ BMS Solutions L.L.C. “ emri i biznesit/ “ BMS Solutions “emri tregtar, me seli në Vushtrri, me ARBK: 811557711, si Operatorë Ekonomik, të cilën e përfaqëson z. Burim Plakolli, në tekstin e mëtejme **KONTRAKTUESI - FURNIZUESI**

janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike, për furnizime , si vijon: **Furnizimi me inventar për shkolla “**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	74	1	7	1	3	6
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	6	2	1	3	6

### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me inventar për nevoja të institucioneve shkollore , në pajtim me Përshkrimin Teknik dhe Specifikat Teknikë dhe përshkrimin teknik të ofertës me nr. Referues : 644-24-062-136**

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzimin e mallit është : 20 ( njëzet ) ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.
- 2.2 Mbikëqyrja e cilësisë dhe sasisë së liferimit të mallit , do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës, Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Kontraktuesi, para nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek A.K. Sigurimin e ekzekutimit të kontratës 10% (dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti-Polisa e sigurimit apo dokument bankar me afat validiteti për perjudhen kohore prej 60 ditësh nga data e specifikuar për lidhjen e kontratës.
- 2.5 Garancioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e mallrave do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranimit të mallit dhe përfundon në një afat prej minimum 6 muajve nga data e pranimit të mallit nga Menaxheri i Kontratës i A.K.

<sup>17</sup> DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Dokumenti – Deklaratë me shkrim që konfirmon garantimin e kualitetit dhe evitimin e defekteve eventuale të shfaqura në inventar Brenda periudhës garantuese, e nënshkruar dhe vulosur nga Kontraktuesi .

### Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 4,400.00€ ( katërmijkatërqind/00€ ).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit / Kryesit të shërbimeve, sipas Kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Kontratës si dhe Komisioni i Pranimit të mallit.

### Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës
- (c) Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme
- (c) PJESA B: Draft kontrata
- (d) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (e) Plani për menaxhimin e kontratës;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


Për Autoritetin Kontraktues: Komuna  
Vushtrri

Për Kontraktuesin : " BMS Solutions LLC "-  
Vushtrri


Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Burim Plakolli
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.09.2024	Data:	26.09.2024
Vula:		Vula:	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit: VU644-24-7417-1-3-6 Numri i brendshëm: VU644-24-059-1-3-6 Titulli: Furnizim me inventar për shkollë

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore									
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
<b>1</b>	<b>Furnizim me inventar për shkollë</b>								
2	<p>Tabela shkrimi (shkollore), me dimensione (120x240) nga MDF I presuar dhe I plastifikuar, me foli ngjyrë të gjelbër, e përshatshme për shkrim. Tabela duhet ta ketë kornizën nga alumini profil U, mbajtësen për shpuzë. Trashësia e tabelaës d=1.8cm.</p> 	COPË	16	55.08	18.00	65.00	881.36	158.64	1040.00

Numri i prokurimit: VU644-24-7417-1-3-6 Numri i brendshëm: VU644-24-059-1-3-6 Titulli: Furnizim me inventar për shkollë

3	<p>Banka për nxenes të nivelit klasor prej 1-5, me dimensione 50x120x65cm, e punuar nga konstruktion tuba metalik, në formë elipse 45x35x2 mm, e ngjyrosur me ngjyrë elektrostatische, këndet e konstruktionit dhe vrimat e tubave të mbulohen me plastika rrjetë metalike. Pjesa mbajtëse e librave të punohet nga metarjali si në foto ose me ne baze të fotos. Pjesa mbajtëse e librave të punohet nga metarjali si në foto ose me rrjetë metalike. Pllaka e bankës e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos së drurit të ahut, me trashësi 22mm, e veshur në sipërfaqe me kompaktaminat me trashësi 0.8mm të jetë e llakuar, skajet e bankës të jenë të zburuara dhe të llakuara. Profilët e brinjëve të pllakes të kenë një rreze prej 5 mm, ndërsa këndet të kenë një rreze harkore prej 30mm.</p> <p>Ngjyrat do të caktohet nga mbikëqyrësi. Për çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p> 	Copë	56	50.85	18.00	60.00	2847.46	512.54	3360.00	
<b>TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH</b>								3,728.81	671.19	4,400.00

**IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

EMRI I OE: BMS SOLUTIONS L.L.C.

EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: BURIM PLAKOLLI

NËNSHKRIMI: *B Plakolli*

DATA: 26.07.2024

VULA:

